

**VENDIM**  
**Nr.5, datë 15.8.1992**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërise, e përbërë nga:

|              |           |                      |
|--------------|-----------|----------------------|
| Rustem Gjata | Kryetar i | Gjykatës Kushtetuese |
| Manol Konomi | Anëtar i  | Gjykatës Kushtetuese |
| Hilmi Dakli  | Anëtar i  | Gjykatës Kushtetuese |
| Veli Budo    | Anëtar i  | Gjykatës Kushtetuese |
| Thimjo Kondi | Anëtar i  | Gjykatës Kushtetuese |
| Ylvi Myrtja  | Anëtar i  | Gjykatës Kushtetuese |
| Franc Jakova | Anëtar i  | Gjykatës Kushtetuese |

Me sekretare Drita Filto, më datën 15.8.1992, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.5 që i përket:

KËRKUES: Nafiz Bezhani, anëtar i Gjykatës së Kasacionit dhe president i shoqërisë "Albanian Diaspora Service"

PERSON I INTERESUAR: Gjykata e Kasacionit, e përfaqësuar nga zëvendëskryetari zoti Avni Shehu.

**OBJEKTI I KËRKESËS**

Interpretimi i dispozitave kushtetuese për papajtueshmërinë e funksionit të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit me funksione të tjera.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

**VËREN:**

Nga shpjegimet e kërkuarit Nafiz Bezhani dhe nga dokumentet e paraqitura rezulton, se ai ka ushtruar profesionin e avokatit. Me iniciativën dhe nën drejtimin e tij është krijuar organizata me karakter shoqëror-ekonomik me emrin "Albanian Diaspora Service", e njohur si person juridik me vendimin nr.840, datë 20.9.1991, të gjykatës së rrethit Tiranë. Kërkuari ka kryer mbi baza vullnetare detyrën e presidentit të kësaj shoqërie. Këtë detyrë vazhdon ta kryejë edhe pas zgjedhjes së tij nga Kuvendi Popullor në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, duke pretenduar, se në ligjin "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe në Ligjin "Për organizimin e drejtësisë..." nuk ka ndonjë dispozitë që të parashikojë papajtueshmërinë e funksionit të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit me funksione të tjera, siç është në rastin konkret funksioni i presidentit të shoqërisë së lartpërmendur.

Ky qëndrim i kërkuarit ka hasur në kundërshtimin e Gjykatës së Kasacionit, drejtuesit e së cilës janë shprehur në disfavor të këtij pretendimi dhe i kërkojnë atij të shkëpusë marrëdhëniet me shoqërinë në fjalë.

Në këto rrethana kërkuari kërkon prej Gjykatës Kushtetuese që, në zbatim të detyrës së saj për interpretimin e Kushtetutës e të ligjeve kushtetuese, të marrë një vendim në favor të tij dhe t'ia njoftojë atë Gjykatës së Kasacionit.

Në mbështetje të pretendimit të tij kërkuari niset nga arsyetimi që për anëtarët e Gjykatës së Kasacionit nuk ka ndonjë ndalim të shprehur me dispozita kushtetuese apo me ligj për ushtrimin e funksioneve të tjera, siç parashikohet për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, i cili, sipas nenit 20 të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"...nuk mund të kryejë veprimtari të tjera publike e private, që mund të çenojnë pavarësinë ose paanësinë e tij".

Në shpjegimet e tij në seancë gjyqësore kërkuari, duke iu referuar nenit 18 të ligjit "Për organizimin e drejtësisë...", pretendoi, se funksioni i tij si president i shoqërisë së lartpërmendur nuk

është i tillë që t'i sjellë atij fitime.

Në kundërshtim me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese është e mendimit se funksioni i anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, ashtu si dhe i gjyqtarëve të tjerë të të gjitha instancave gjyqësore, është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër publik ose privat që sjell fitime. Në këto raste nuk ka rëndësi vetëm fakti nëse fitimet materiale apo përfitime të llojeve të tjera sigurohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, apo thjesht ekziston mundësia e përfitimeve të ndryshme. Rëndësi ka që të mos cënohet parimi kushtetues i pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës si institucion dhe i çdo gjyqtari të veçantë. Për rrjedhojë, neni 18 i ligjit "Për organizimin e drejtësisë..." nuk mund të interpretohet ngushtë, duke pasur parasysh vetëm përfitimet materiale e monetare të drejtpërdrejta në bazë të marrëdhënies së punës.

Jemi të mendimit se kjo dispozitë ka nevojë të plotësohet e të saktësohet në të ardhmen duke treguar në mënyrë indikative disa nga rastet e papajtueshmërisë së funksioneve.

Në të njëjtën kohë duhet të shmanget pjesa referuese e pasaktë "... si dhe me ato detyra, të cilat i ndalohen shprehimisht me ligj", e cila në një shikim formal, mund të lerë shkas të interpretohet "ad contrario" në favor të pretendimit të kërkuarit, e si rrjedhojë, të bjerë ndesh me parimin kushtetues të pavarësisë e të paanësisë së gjykatave. Sidoqoftë, dispozita ligjore, sado e plotë që të formulohet nuk mund të parashikojë në mënyrë të shprehur zgjidhjen e çdo rasti konkret që nxjerr jeta, prandaj ato mund të zgjidhen drejt vetëm në qoftë se nuk lenë asnjë shkas për shmangie nga parimi kushtetues i lartpërmendur.

Përsa i përket rastit objekt gjykimi, nga vetë Statuti i Shoqërisë "Albanian Diaspora Service" rezulton, se ajo si person juridik zhvillon edhe një veprimtari të gjerë me karakter ekonomik e siguron fitime. Në të njëjtën kohë presidenti i shoqërisë, ndonëse detyrën e kryen vullnetarisht, ashtu si dhe këshilltarët e aktivistët e tjerë, mund të përfitojë nga shpërblimet dhe dhuratat. Për më tepër, sipas Statutit, presidenti ka të drejtën e disponimit të fondeve të shoqërisë. Në të njëjtën kohë shoqëria në fjalë, e organizuar si person juridik, për të ushtruar veprimtarinë e saj, ka të drejtë të hyjë në një numër marrëdhëniesh juridike me subjekte të tjera e për rrjedhojë, mund të paraqitet edhe si paditëse apo e paditur në gjykata, pa përjashtuar edhe Gjykatën e Kasacionit, anëtar i së cilës është presidenti i saj. Në këto rrethana është evidente mundësia e shkeljes së parimit të paanësisë së gjykatave në zgjidhjen e çështjeve, ose së paku krijimi i opinioneve negative në këtë drejtim.

Për arsyet e përmendura më lart Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin kategorik që funksioni i anëtarit të Gjykatës së Kasacionit është i papajtueshëm me funksionin e presidentit të shoqatës "Albanian Diaspora Service". Për rrjedhojë, zoti Nafiz Bezhani, duhet të vendosë menjëherë ose të heqë dorë nga detyra e presidentit të shoqatës, ose të kërkojë lirinë nga detyra e anëtarit të Gjykatës së Kasacionit.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24(1), 25, 26 dhe 27 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

#### VENDOSI:

Ta konsiderojë të papajtueshëm funksionin e anëtarit të Gjykatës së Kasacionit me çdo funksion tjetër publik ose privat që lë shkas për cënimin e parimit kushtetues të pavarësisë e të paanësisë së gjykatave.

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në "Fletoren Zyrtare".

Tiranë, më 15.8.1992